

Analiza e profilit social dhe funksional të bashkëpunëtorëve në dosjen e Mitat Havari: tipologji, rekrutim dhe efektivitet raportimi

Msc. Oralda Muço & MSC. Anxhela Dervishi

Specialiste në Sektorin e Kërkesave të Palëve të Treta, Bashkëpunëtorëve dhe të Favorizuarve, në Drejtorinë e Informacionit

Referues: Msc. Oralda Muço

Oralda Muço është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, dhe ka përfunduar studimet e Masterit Profesional në Arkivistikë. Gjithashtu, ka përfunduar Masterin Shkencor në programin “Drejtësi Tranzitore” në Fakultetin e Shkencave Sociale. Aktualisht, ushtron detyrën e Specialistes në Sektorin e Kërkesave të Palëve të Treta, Bashkëpunëtorëve dhe të Favorizuarve, pranë Drejtorisë së Informacionit në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Përvoja e saj profesionale është e lidhur ngushtë me administrimin e dokumentacionit arkivor, trajtimin e kërkesave për informim dhe promovimin e të drejtës për njohjen e së kaluarës, në funksion të transparencës institucionale dhe proceseve të drejtësisë tranzitore. Interesat e saj kërkimore përfshijnë arkivistikën, kujtesën historike, të drejtat e njeriut dhe drejtësinë tranzitore, fusha në të cilat ka kontribuar përmes angazhimit të saj profesional dhe institucional.

Anxhela Dervishi juriste, e diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe mbajtëse e gradës Master Shkencor “E Drejtë Penale” nga Kolegji Universitar “Luarasi”, Tiranë. Aktualisht punon pranë Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit si Specialiste në Sektorin e Kërkesave të Palëve të Treta, Bashkëpunëtorëve dhe të Favorizuarve, në Drejtorinë e Informacionit. Në veprimtarinë e saj profesionale është e angazhuar në trajtimin e kërkesave për informim dhe në administrimin e procedurave që lidhen me aksesin në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Interesat e saj profesionale përfshijnë të drejtën penale, të drejtën e informimit, transparencën institucionale dhe çështjet që lidhen me kujtesën historike dhe drejtësinë tranzicionale.

Abstrakt

Ky punim ofron një analizë të profilit të bashkëpunëtorëve të evidentuar në dosjen në ngarkim të shtetasit Mitat Havari, duke u fokusuar në karakteristikat e tyre identifikuese, sociale dhe funksionale. Qëllimi kryesor është identifikimi i tipologjisë së këtyre individëve dhe vlerësimi i rolit të tyre në procesin e mbledhjes dhe transmetimit të informacionit. Studimi bazohet në analizën sistematike të të dhënave për secilin bashkëpunëtor, duke përfshirë elemente si mosha, gjinia, profesioni, niveli arsimor dhe gjendja ekonomike, të cilat shërbejnë për ndërtimin e një profili social dhe demografik të tyre dhe për kuptimin e kontekstit të veprimit.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i kushtohet mënyrës së rekrutimit, duke analizuar format dhe rrethanat që kanë ndikuar në përfshirjen e tyre në bashkëpunim. Punimi trajton gjithashtu aktivitetin raportues të bashkëpunëtorëve, duke shqyrtuar numrin e raporteve të dorëzuara dhe numrin e subjekteve për të cilët është dhënë informacion. Kjo mundëson vlerësimin e nivelit të angazhimit dhe intensitetit të bashkëpunimit, si dhe evidentimin e dallimeve ndërmjet individëve të ndryshëm.

Për më tepër, analizohet lidhja ndërmjet karakteristikave personale dhe efektivitetit në dhënien e informacionit, me synim identifikimin e modeleve të mundshme që lidhen me përzgjedhjen dhe funksionimin e bashkëpunëtorëve, si dhe faktorët që ndikojnë në performancën e tyre.

Në përfundim, studimi synon të kontribuojë në një kuptim më të thelluar të profilit të bashkëpunëtorëve dhe mekanizmave të bashkëpunimit të evidentuar në këtë dosje, duke ofruar një qasje të strukturuar analitike mbi tipologjinë dhe funksionimin e tyre.

Fjalë kyçe: *bashkëpunëtorë, profil social, analizë demografike, rekrutim, aktivitet raportues, tipologji bashkëpunëtorësh, analizë funksionale, dosje hetimore.*